

AMBASADA NË ZAGREB, KROACI

(5 prill 2022, Zagreb) – Përpilues: Dr. Martin Berisha, Ambasador

Aktivitetet e përgjithshme

Gjatë tremujorit të I (parë), në periudhën Janar – Mars, të Vitis 2022, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Zagreb janë zhvilluar aktivitete të shumta si zhvillime kryesore gjatë këtij tremujori, të cilat janë të paraqitura si në vijim:

- Takime me përfaqësuesit e institucioneve qendrore qeveritare dhe parlamentare kroate,
- Takime me kryetarët e prefekturave dhe të qyteteve të Kroacisë,
- Takime me ambasadorët e misioneve diplomatike të akredituara në Kroaci,
- Organizime të vizitave të ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Kroaci,
- Takime me përfaqësues të kompanive/firmave të ndryshme kroate lidhur me bashkëpunimin ekonomik,
- Takimet me përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave të arsimit, të kulturës dhe të sportit,
- Pjesëmarrje në aktivitetet e organzuara me rastin e përkujtimin e 91 vjetorit të vrasjes së albanologut Dr. Milan fisnik Shufflay, si dhe në panelin shkencor me temën “Veprimtaria e Politikanit dhe Historianit Shufflay në fushën e Kulturës Shqiptare”,
- Pjesëmarrje në pritet tradicionale për anëtarët e Trupit Diplomatik në Republikën e Kroacisë,
- Pritje dhe bashkëbisedim me qytetarët dhe përfaqësuesit e shoqatave Shqiptare dhe Unionit të Shqiptarëve në Kroaci,
- Pjesëmarrje në programe dhe manifestimeve për shënimin e 14 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, të ndryshme të organzuara nga shoqatat dhe Unioni i Shqiptarëve në Kroaci,
- Pritje në Ambasadën e RKS në Zagreb të profesorëve të universiteteve nga Kosova, profesorëve të fakulteteve nga Zagrebi,
- Takime me përfaqësuesit e konfekSIONEVE fetare prezantë në Kroaci.

1. Takim me Bruno Vidaković - Drejtor Ekzekutiv i “Asociacionit për zhvillim regional në Evropën Juglindore”, Zagreb

Më datën 12 janar, në hapësirat e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Zagreb, është mbajtur takim me z. Bruno Vidaković-Drejtor Ekzekutiv i “Asociacionit për zhvillim regional në Evropën Juglindore” dhe “Shine Solar Group-Sjaj Grupacija d.o.o.”, në Zagreb.

Takimi është mbajtur me kërkesën e z. Vidaković, me qëllim të prezantimit të veprimit të firmave të përmendura më lart dhe mundësisë së bashkëpunimit me institucionet e Republikës së Kosovës, në projekte ekologjike zhvillimore, në lëmi të ndryshme.

Z. Vidaković, theksori se veprimtaria e firmave të cilat i përfaqëson, realizon projekte të përmasave transnacionale, në ofrimin e shërbimeve të aspektit të ekologjisë së pastër, në fushat e ngritjes së kapaciteteve energetike, mbledhjen dhe shfrytëzimin e mbeturinave, 18 lloje, si shfrytëzimi ekonomik i ujërave të zeza, ndërtimi i kanalizimeve individuale, mbledhja dhe shfrytëzimi ekologjik e plastikës, mbeturinave spitalore, mbetjeve/hekurishtet e armëve, të veturave, mbetjet inerte të thëngjillit nga termoelektranat, eliminimi i tymit dhe gazzave, si dhe grumbullimi i karbonit, përpunimi, shitja dhe shfrytëzimi ekonomik i tyre 100%, me teknologji moderne dhe pastruese të ambientit. Gjithashtu në veprimtarinë e tyre kanë edhe çështjet minerare, me fokus në grumbullimin e argjendit.

Z. Vidaković, theksori se ka kontakte të mira në Kosovë, dhe se para disa viteve ka pasur kontakte e takime me qeveritë e mëparshme! Ka bashkëpunim me firma të mëdha botërore, dhe bënë koncepte zhvillimore për ata, si psh. 'VERSACE', duke theksuar se kane partner shumë të mëdhenj, me firma të ndryshme nga Australia, Kina, Korea, Rusia etj.

Ai gjate prezantimit theksoi që sidomos kanë kapacitete ndërtimore dhe se sidomos e potencon që termoelektranat mund të i shndërrojnë dhe funksionojnë pa tymtar, ndërsa në vend të tymtarëve ndërtojnë salla, ku mund të grumbullohet tymi dhe karboni i tubuar mund të shfrytëzohet për ekonomi në ndërtimtar!

Z. Vidaković, shpreh interesimin për bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Kosovës në projekte të shumta, duke potencuar se e gjithë veprimtaria e realizimit të projekteve, të firmave të cilat ai i përfaqëson është me teknologji ekologjike bashkëkohore.

2. Bashkëbisedim me përfaqësuesit e shoqatave Shqiptare dhe Unionit të shqiptarëve në Kroaci

Më datën 17 janar, me organizimin e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Zagreb, një numër i madh i bashkatdhatarëve tonë të organizuar në Unionin Shqiptar, bashkësi dhe shoqata kulturore si dhe prijesit shpirtëror të komunitetit tonë, sot vizituan Ambasadën e Republikës së Kosovës në Zagreb në kuadër të projektit "Dyert e hapura të Ambasadës", me ç'rast, ambasadori Dr. Martin Berishaj u dëshroi mirëseardhje në shtëpinë e tyre të përbashkët.

Bashkatdhatarët tonë përkujtuan me një minute heshtje ditën e vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, si dhe për bijtë tanë që dyzet vite më parë ranë nga dora tinëzare e regjimit jugosllav, vëllezërët Gervalla dhe Kadri Zekën, që ranë për të mos vdekur kurrrë!

Ambasadori Dr. Berishaj, pas përhëndetjes dhe mirëseardhjes, në fillim bëri një prezantim të shkurtër të veprimtarisë dhe personelit të Ambasadës, duke vazhduar me një fjalë rasti, e nga cila do të veçojmë:

"Më lejoni që sot t'i përkujtojmë pjestarët e komunitetit shqiptarë që sot nuk janë më me ne, e që janë gjurmë të pashtyera: si Gjeneral Tom Berishaj, Prof. Dr. Zef Mirdita, Gjeneral Ramiz Abdyli, Dr. Lush Daka, Prof. Dr. Aleksandër Stipčević, heronjtë e kombit Fehmi Lladrovci, Bekim Berisha - Abeja, Xhelal Hajda - Toni, Agim Ramadani e shumë të tjera, duke mos harruar edhe veprimtarë të tjera të komunitetit sikurse, Dr. Muhamet Nexhipi, Myzafer Rexhepi, Pashko Kabashi, Mikel Kuzhnini."

Posaçërisht Ambasadori Dr. Berishaj theksoi rolin e madh të intelejgencës kroate të shekullit XIX sikurse ishin fra Gerga Martić dhe Silvie Strahimir Kranjčević që ndikuan në mbarësimin e idesë kombëtare shqiptare tek At Gjergji Fishta, At Shtjefën Gjeçovë si dhe rolin e madh që kishte shkencëtarë i madh kroat dr. Milan Šufflay.

"Ju si komunitet shqiptar, në ditët më të lavdishme të kombit tonë, u rreshtuat në kahun e duhur dhe me veprimtarinë tuaj patriotike i dhatë fisionomi Shtetit të Kroacisë dhe Shtetit të Kosovës. Shteti i Kosovës, nuk i harron ato, sepse ai nuk është thjeshtë një shtet i ri, por është shtet dhe ashtu sillemi"

Tutje Ambasadori Dr. Berishaj theksoi se "Marrëdhënia e Shtetit të Kosovës dhe Kroacisë do të mbështetet në shtylla të forta; nga ato politike, ushtarake, arsimore dhe pa dyshim në hapjen e derës së Kosovës për investime kroate dhe anasjelltas ato të Kosovës në Shtetin Kroat. Ambasadori Dr. Berishaj, në fjalën e vet shtoi se Qeveria e Kosovës, ka për synim demokratizimin e shoqërisë, sundimin e ligjit dhe luftën kundër korruptionit. Aleanca natyrore në mes dy shteteve duhet të përditësohet në shumë lëmi. Shteti Kroat ka shprehur interesim për të na mbështetur në synimet tona, në anëtarësim në organizata ndërkombëtare si dhe me ndikimin e vet do të ndikojë në shtetet të cilat ende nuk na kanë njohur. Për këtë jemi shumë falënderues."

Të pranishmëve gjithashtu iu drejtua Deputetja shqiptare në Parlamentin e Kroacisë, znj. Ermina Lekaj Perlaskaj, e cila në fjalën e vet i dëshiroi mirëseardhje Ambasadorit Dr. Martin Berishaj duke i ofruar bashkëpunim të frytshëm dhe mbështetje pa rezervë në Parlamentin Kroat, ku i artikulon interesat e përbashkëta të shqiptarëve, boshnjakëve, malazezëve, sllovenëve dhe maqedonasve.

3. Pritje e delegacionit të profesorëve nga Fakulteti Juridik në Prishtinë

Më datën 18 janar, delegacioni i Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës i prirë nga Prof..Avni Puka – Dekan, Prof. Muhamet Vokri - Prodekan (Koordinator i mësimit klinik) Prof.Enver Hasani (ish-Kryetar i Gjykatës Kushtetuese), Prof. Bedri Peci, Prof.Visar Morina, i cili me ftesë të Fakultetit Juridik të Universitetit të Zagrebit, gjendet në vizitë studimore në kuadër të projektit “ENEMLOS” për klinikat juridike (Erasmus+) ku edhe janë partnerë, u prit në ambientet e Ambasadës së Kosovës nga Ambasadori i Kosovës në Kroaci Dr. Martin Berishaj, me bashkëpunëtorë.

Në takim mori pjesë edhe deputetja shqiptare në Kuvendin e Republikës së Kroacisë znj. Ermina Lekaj Përlaskaj.

Bashkëpunimi ndëruniversitarë në mes Kosovës dhe Kroacisë, pa dyshim është një mundësi e shkëlqyer për të avancuar kërkimet shkencore si dhe bartjen e praktikave të mira që universitetet në Kroaci kanë, në veçanti Universiteti i Zagrebit i cili daton nga viti 1669.

Dekani i Fakultetit Juridik Prof. Puka, shpjegoj se ky projekt me Fakultetin Juridik të Zagrebit zhvillohet në kuadër të projektit “ENEMLOS” për klinikat juridike (Erasmus+). Në takim të përzemërt, u shpalua ideja për bashkëpunim të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës edhe me fakultetet juridike në Universitetin e Rijekës dhe të Splitit.

4. Bashkëpunimi ndëruniversitar Kosovë - Kroaci

Më datën 20 janar, në vazhdën e takimeve që Ambasada e Republikës së Kosovës në Zagreb ka vendosur si cak, lidhur me bashkëpunim me Universitetet në Kroaci, Ambasadori Dr.Martin Berishaj priti UD Rektorin e Universitetit Libertas të Zagrebit, Profesor Emeritus, Ivo Andrijanić.

Ambasadori Dr. Berishaj, njoftoi Prof. Emeritus Ivo Andrijanić, për interesin e shprehur për bashkëpunim të Universiteteve në Kosovë me universitetet në Kroaci, për shkëmbim të studentëve dhe profesorëve në të gjitha nivelet studimore.

Prof. Emeritus Andrijanić, përshtëndeti idenë dhe shprehu gatishmëri për këtë, duke shtuar se përpos nivelit baçelor dhe masteri, kanë edhe Programin e Doktoraturës në Marrëdhënie ndërkombëtare dhe Diplomaci, ku numri i studenteve doktorant është i përkufizuar vetëm në 20 vetë. Në Programin e Doktoraturës vijojnë student nga SHBA-të dhe BE. Prof Emeritus Ivo Andrijanić gjithashtu potencoi se në Universitetin Libertas studiojnë një numër i madh i studentëve shqiptarë nga të gjitha viset e banuara me shqiptarë.

5. Kryetari i Qytetit të Dubrovnikut z. Mato Franković priti sot përzemërsisht Ambasadorin e Republikës së Kosovës në Kroaci Dr. Martin Berishaj

Më datën 21 janar, në pritjen e organizuar për Ambasadorin, Kryetari Franković ishte i shoqëruar me Nënkyetaren znj. Jelka Tepšić dhe Drejtoreshën për fonde evropiane, bashkëpunim ndërkombëtarë dhe regional znj. Zrinka Raguž.

Gjatë bisedës Ambasadori Dr Berishaj e njoftoi Kryetarin e Dubrovnikut z. Franković lidhur me faktin se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës ka nisur projektin “Rigjenerimi i qytetit të vjetër të Janjevës” hapësirë kulturore tradicionale e cilësuar si aset i trashëgimisë kulturore nën mbrojtje ligjore.

Me realizimin e projektit të rigjenerimit të Qytetit të Vjetër të Janjevës si aset i çmuar i trashëgimisë kulturore, në nëntor 2021, Dr. Berishaj shtoi se MKRS ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me UNDP-në në Kosovë, në funksion të përmirësimit të kushteve të jetesës së banorëve përmes restaurimit të ndërtimeve tradicionale dhe promovimit të turizmit kulturor të Janjevës.

Kryetari Franković shprehi gatishmërinë që Qyteti i Dubrovnikut dhe institucionet e përkatëse të trashëgimisë kulturore dhe të planifikimit hapësinor dhe zhvillimor të tij, të ofrojë mbështetje në fushën e konservimit dhe administrimit të hapësirave dhe ndërtesave të trashëgimisë kulturore në Komunat e Kosovës, si dhe të bëjnë vizita profesionale për tu njojur me praktika të funksionimit të integruar të inspepcionit të ndërtimit në Qytetin e Dubrovnikut dhe të inspepcionit të trashëgimisë kulturore, në rastet kur rrezikohen hapësirat dhe ndërtesat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore nga veprimet ilegale apo mosrespektimi i lejeve ndërtimore dhe masave të mbrojtjes së Trashëgimisë kulturore. Poashtu u fol edhe për mundësinë e ndihmesës së Qytetit të Dubrovnikut me analizën dhe trajnimin e personelit rrith procedurave dhe përgatitjes së dosjes së asetit të trashëgimisë kulturore për aplikim në Listën e Trashëgimisë Kulturore Botërore të UNESCO-s.

Ambasadori Dr. Berishaj shprehi interesimin që Qyteti i Dubrovnikut si pjesë e trashëgimisë kulturore botërore ta ndihmojë Kosovën duke e mbështetur atë në anëtarësim në organizatat ndërkombëtare me veçanti në UNESCO.

6. Ambasadori, Dr. Martin Berishaj mori pjesë në pritjen tradicionale për anëtarët e Trupit Diplomatik në Republikën e Kroacisë

Më datën 24 janar, në Pallatin Dverce të Qytetit të Zagrebit, Kryetari i Bashkisë z. Tomislav Tomašević, me bashkëpunëtorë, organizoi pritje tradicionale për anëtarët e Trupit Diplomatik në Republikën e Kroacisë, të udhëhequr nga nunci apostolik Doyenne Giorgio Lingua.

Në emër të Trupit Diplomatik dhe në emër të misioneve konsullore dhe organizatave ndërkombëtare me qendër në Zagreb, Nunci apostolik Giorgio Lingua u falënderua për pritjen tradicionale të Vtit të Ri.

Duke shprehur mirënjojen si dhe falënderimin e tij për bashkëpunimin konstruktiv deri tani, kryetari Tomašević njoftoi anëtarët e Trupit Diplomatik për zbatimin e politikave të ndryshimit për një Zagreb më të mirë, duke shtuar “në këtë kuptim, se ne jemi më shumë se të hapur ndaj bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave të mira të vendeve tuaja në mënyrë që ta bëjmë Zagrebin një vend më të mirë për cilindo”.

7. Takim me përfaqësuesit e mediave lidhur me promovimin e filmit Zgjoi

Më datën 26 janar, në promovimin e kinematografisë kosovare, në veçanti, filmit “Zgjoi”, ambasadori Dr. Martin Berishaj u takua në Ambasadën tonë, me bartësit kryesor të mediave në Kroaci; Agjencioni i lajmeve kroate “Hina”, “Jutarnji list”, “Slobodna Dalmacija” dhe “Veçernji list” si dhe bartësve të show programeve në hahapsirën kulturore kroate si dhe në fushën e arteve pamore; Branka Vojvodić (nga HINA), Hassan Haidar Diab (nga Veçernji list) dr. Sanja Nakicevic nga fakulteti për kulturologji i Universitetit të Zagrebit, si dhe gitaristit me famë boërore z Petrit Çeku, i cili punon dhe vepron në Zagreb.

Në eksplikimin e ambasadorit Dr. Berishaj, përfaqësuesëve të mediave të lartëpermendura veçojmë, „... filmi bazohet në ngjarjet e vërteta të vejushës së luftës në Kosovë, Fahria, e cila ka qenë në kërkim të bashkëshortit të saj të zhdukur në luftë për vite me radhë, dhe në luftën e saj për pavarësi në një shoqëri thellësish patriarkale. Film i fitoi tre çmime kryesore në Festivalin e Filmit Sundance: Çmimin e Madh të Jurisë, Çmimin për Regjisoren më të Mirë dhe Çmimin e Audiencës. Regjisora Blerta Basholli eksploroni çështje sociale dhe seksuale në vendlindjen e saj,

Në takim u shpaluan idetë që mediat në fjalë, të batojnë tekstin që promovon idenë e filmit i cili tashmë është pjesë e top listës e përzgjedhur për çmimin Oskar, e të cilin ambasadori Dr. Berishaj ua dorëzoi bashkëbiseduesve në fjalë.

8. Takim me Ministrin e Punëve të Jashtme të Kroacisë z. Gordan Grlić Radman

Më datën 31 janar, Ambasadori i Kosovës në Kroaci, Dr. Martin Berishaj dhe Këshilltari z. Eqrem Haziri u priti në takim njoftues nga Ministri i Punëve të Jashtme i të Kroacisë z. Gordan Grlić Radman, z. Ivan Mašan, Këshilltar i ministrit dhe znj. Vedrana Pološki, Sekretare e Dytë në Drejtori të Përgjithshme për Evropën juglindore.

Në takim të përzemërt, u diskutua për situatën politike në rajon dhe rolin e Kroacisë në mbështetje të proceseve politike të rrugetimit të Kosovës si shtet, si dhe për bashkëpunimin e mëtejshëm ndërmjet dy shteteve.

Ambasadori Dr. Berishaj e falënderoi Ministrin Grlić Radman për përkrahjen e vazhdueshme të shtetit kroat për Kosovën duke e shprehur përkushtimin për forcimin e mëtejshëm të raporteve bilaterale.

Ambasadori Dr. Berishaj poashtu u shpreh se komuniteti shqiptarë në Kroaci është komunitet i cili është integruar mirë në shoqërinë kroate, i cili gjëzon respekt të madh nga ana e shteti kroat.

Minsitri Grlić Radman, shtoi se Kroacia është shtet mik i Kosovës. Ajo përcjell me vëmendje të shtuar zhvillimin e proceseve politike në Kosovë duke mbështetur atë në rrashin diplomatik dhe duke inkurajuar në reformat e filluara të Qeverisë së Kosovës, në drejtësi, luftën kundër korruptionit, vendosjen e shtetit të drejtës dhe përbillyjen e suksesshme të procesit të dialogut me Serbi.

9. Pritje e ambasadorit Dr. Martin Berishaj, nga nunci mons. Giorgio Lingua

Më datën 02 shkurt, në Nunciaturën apostolike në Zagreb, nga nunci mons. Giorgio Lingua i cili është njëheri edhe Doayen i Korit Diplomatik në Kroaci, u priti ambasadori i Kosovës Dr. Martin Berishaj.

Ambasadori Dr. Martin Berishaj i shprehi konsideratat për Selinë e Shenjtë duke shtuar se shteti i Kosovës ka besnikëri të pa ndarë për vlerat civilizuese evropiane, orientim të quartë për zhvillim të shtetit të drejtës, respektimin e të drejtave të komuniteteve etnike dhe fetare si dhe përkushtimit tonë për fqinjësi të mirë dhe paqe në rajon. Ky rrugetim yni në zhvillim të proceseve demokratike është pa dyshim garancë e fortë dhe dëshmi e mirë për të na pranuar shtetet që janë në proces të njohjes së Kosovës!

10. Pritje e ambasadorit Dr. Martin Berishaj, nga Kryetari i Qytetit te Zarës z Branko Dukić

Më datën 03 shkurt, Kryetari i Qytetit te Zarës z Branko Dukić me Mr. sc. Anita Gržan Martinović këshilltare e lartë, specialiste për marrëdhënie ndërkombëtare e priti në takim zyrtar ambasadorin e Kosovës Dr. Martin Berishaj.

Pas prezantimit të arriturave në qytetin e Zarës, Kryetari i Qytetit z. Branko Dukić i uroi ambasadorit të Kosovës mbarësi ne detyrën e re duke i ofruar, mbështetje në shumë fusha; në bartjen e praktikave të mira në sektorin e kulturës, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e artefakteve, arkivave dhe strukturimit të tyre, arsimit të lartë, në veçanti në arkeologji dhe shkenca shoqërore, si dhe në gjetjen e mundësive për bashkëpunim ekonomik për bizneset e vogla dhe të mesme. Dr. Berishaj shprehi kënaqësinë dhe falënderimin e tij për mbështetje të ofruar duke shtuar se Kosova Zarën e përjeton shumë afër, sepse këtu me shekuj jetojnë arbëreshet që i dhanë kulturës kroate dhe asaj shqiptare përmbytje cilësore e që janë fije lidhëse në mes nesh, poashtu shtoi se jemi të hapur dhe mirëpresim bashkëpunimin për të gjitha fushat.

11. Takim në kompaninë Eriksson Nikola Tesla d.d. Zagreb

Më datën 02 shkurt, Ambasadori Dr. Martin Berishaj, i shoqëruar nga Eqrem Haziri, Këshilltar, ishin në vizitë në kompaninë Eriksson Nikola Tesla d.d. Qëllimi i vizitës ishte vuarja e kontaktave me Kompaninë për mundësitetë e bashkëpunimit dhe investimeve në Kosovë, nga kompania me renome.

Nga kompania Eriksson Nikola Tesla d.d., mysafirët nga Ambasada e RKS në Zagreb, i priten znj. Gordana Kovačević, MSc - Kryetare e kompanisë dhe Mr.sc Milan Živković - Drejtor për Strategji dhe zhvillim të kompanisë.

Znj. Gordana Kovačević, që në fillim bëri një prezantim të kompanisë lidhur me funksionimin, duke theksuar se kompania ka Bordin Menaxhues, i cili mbikëqyret nga një person (nga vet presidentja), ndërsa z. Milan Živković, si drejtor i kompanisë është përgjegjësi për bashkëpunim me organet shtetërore në secilin vend ku jemi prezent, duke shtuar se jemi kompani shumë serioze në tregun evropian dhe kontribuojmë me ide novatore.

Kompania ka 3471të punësuar (2021), është 50% e shtrirë në Kroaci, ka tregun për 'A1 Croatia', 'Hrvatski Telekom-DT', Ministrinë e Shëndetësisë dhe Administratës Publike, dhe është liderë në Kroaci. Eriksson është prezentë në 180 vende nëpër botë.

Kompania Nikola Tesla d.d, ka 72 vite që funksionon me sukses dhe ka shënuar rezultate pune të shkëlqyeshme, ndërsa nga viti 1953 jemi partnere me Eriksson nga Suedi, e themeluar në 1876 nga Lars Magnus Eriksson.

Në vitin 1977 është nënshkruar marrëveshja e pare me 'digjital EXE', ndërsa në vitin 1995 Erikssoni bleu 49.7% të aksioneve, dhe jemi në Bursën e Zagrebit, vlera e të cilëve është 2000 kuna (300 euro), ndërsa blerja është në mënyrë standarde, ku aksionaret marrin dividendë sipas pjesëmarrjes. Kompania punon në disa projekte, si në lëmine e shëndetësisë (çertifikatën COVID 19), në lëmine e bujqësisë, në ekologji (vendosja e senzorëve lidhur me zbulimin dhe njoftimin për lajmërimin e insekteve të ndryshme nëpër plantacione). Ka bashkëpunim me Universitetin e Zagrebit dhe Rijekës.

Në Kosovë ka bashkëpunim me IPKO, me Telekomin e Kosovës me industrinë dhe konsumator të shoqërisë, është e dedikuar/orientuar për partneritet në transformimin digjital, me potencial të lartë për bizneset dhe ngritjen e kualitetit të jetës me prioritet:

- Në modernizimin e Telekomit të Kosovës – rrjetin JSC, duke prezantuar 5G,
- Duke kontribuar në kampusin e faturimit 5G për start-ups dhe qëllime akademike, në Parkun Inventiv dhe Trajnues në Prizren,
- Pjesëmarrje në projektet e sigurisë publike,
- Ofrimi i një eksperience dhe zgjidhjeve të gjera në fusha të ndryshme, si dixhitalizimi i TV, shëndetësi elektronike dhe kadastër.

12. Takim me znj. Maja Apostolovska Balaburski, Ministër Fuqipotë, Zv-ambasadore në Ambasadën e Maqedonisë Veriore në Kroaci

Më datën 03 shkurt, në Ambasadën e Republikës së Kosovës, z. Eqrem Haziri, Këshilltar, priti në një takim znj. Maja Apostolovska-Balaburski, Ministër Fuqipotë, Zv-ambasadore në Ambasadën e Maqedonisë Veriore në Kroaci.

Në një takim miqësor me znj. Maja Apostolovska-Balaburski, diskutuan për marrëdhëniet e shkëlqyera mes të dy vendeve tonë, si dhe shprehëm gatishmërinë për intensifikimin e bashkëpunimit në shumë fusha me interes të përbashkët.

Bashkëbiseduam partneritetin dhe përpjekjet për të avancuar proceset, në fushën e ekonomisë, infrastrukturës, si lidhur me auto-udhën Prishtinë-Shkup, ku znj. Apostolovska-Balaburski tha se shpreson se pala maqedonase shpejt do të ndërmerr veprimet për përfundimin e pjesës së auto-udhës që i takon asaj, në funksion të një të ardhme prosperuese dhe të sigurte, për Kosovën dhe Maqedoninë Veriore.

Znj. Apostolovska, tha se në përpjekje të krijimit të rrethanave paqësore dhe të sigurisë në rajon dhe më gjere, me angazhimin e faktorit ndërkombëtar e kemi zgjedhë situatën e mosmarrëveshjes me Greqinë, lidhur me emrin, tani jemi në proces të zgjedhjes së situatës edhe me Bullgarinë, e cila kohëve të fundit paraqet disa pretendime lidhur me identitetin e popullit Maqedonas.

Në një prezantim të shkurtër për situatën në Republikën e Kosovës, z. Haziri, njoftoi se Kosova si një shtet i ri demokratik garanton të drejta dhe liri të barabarta për të gjithë qytetarët e saj, dhe se Qeveria e Republikës së Kosovës është duke vazhduar me përkushtim në punën dhe aktivitetet e saj në stabilizimin e gjendjes ekonomike, sidomos në inkurajimin dhe përkrahjen sektorin e prodhimeve vendore, rritjes së eksportit, sjelljen e investitorëve në Kosovë, stabilizimin e gjendjes me energji, duke shtuar se tani se edhe situate e sigurisë është më e qetë dhe stabile.

Me këtë rast, z. Haziri shprehi mirënjohjen dhe falënderimin të institucioneve të Republikës së Kosovës për dëmbështetjen e vazhdueshme të Republikës së Maqedonisë Veriore ndaj Kosovës, si një partnere fqinje dhe mike, në lidhje me procesin e liberalizimit të vizave dhe integrimit evropian, si dhe në rrugëtimin tonë në shtetëndërtimin dhe integrime euro-atlantik.

Ndërsa nga ana e saj znj. Maja Apostolovska-Balaburski, u shpreh falënderuese për mirëpritjen dhe i ofroi gatishmërinë e plotë për bashkëpunim, duke shtuar se ishte e lumtur për një takim miqësor, ku ndër të tjera u vlerësua bashkëjetesa dhe toleranca ndër-fetare në Kosovë.

U pajtuam që të në vazhdimësi të punojmë bashkërisht për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit, dhe që raportet e shkëlqyera në mes të dy vendeve tonë, t'i forcojmë edhe më tutje.

13. Takim me përfaqësueset e Shoqatës Kroate të Artistëve të Bukur/arteve të bukur

Më datën 07 shkurt, Ambasadori i Kosovës në Kroaci, Dr. Martin Berishaj dhe Këshillari z. Eqrem Haziri, në ambientet e Ambasadës në Zagreb pritën në takim përfaqësueset e HDLU (Hrvatsko Društvo Likovnih Umjetnika (Shoqata Kroate e Artistëve të Bukur), znj. Martina Miholić, udhëheqëse e projekteve dhe znj. Luja Šimunović, kuratore (kustose), në Bashkësinë Kroate të arteve të bukur, në Zagreb.

Qëllimi i vizitës ishte lidhja e kontaktave të bashkëpunimit në mes Kosovës dhe Kroacisë, lidhur me promovimin e vlerave të kulturës së Kosovës në shfaqjet e ndryshme që organizohen në Kroaci.

Znj. Martina Miholić në fillim njoftoi për ngjarjen e ardhshëm të Sallonit të 36-të Rinor, i cili do të mbahet në Shtëpinë e HDLU (Pavijoni i Meštrović, 20 prill - 19 qershor 2022).

Salloni Rinor është ekspozita më e respektuar që prezanton, promovon dhe inkurajon krijimtarinë artistike të artistëve të brezit të ri deri në moshën 35 vjeç që nga viti 1968, dhe tradicionalisht zhvillohet në një ritëm dyvjeçar.

Salloni i 36-të Rinor është ndërkombe tarizuar në bashkëpunim me një brez të ri ekspertësh, kustosësh (kuratorësh), autorësh dhe artistësh. Kolektivi 'KUĆĆA' fton artistë, kustos dhe filozofë rajonal, praktikat dhe qasjet bashkëkohore të të cilëve sjellin vlerë të shtuar në Sallonin e 36-të Rinor duke krijuar një dialog midis skenës kroate dhe asaj ndërkombe tarizuar.

Kolektivi 'KUĆĆA' ka përfshirë edhe z. Dardan Zhegrov nga Kosova. Përfaqësueset e Shoqatës Kroate të arteve të bukura e shohim si një mundësi të mirë për të përfshirë Ambasadën e Republikës së Kosovës me një program që përfaqëson më gjërisht kulturën dhe në përgjithësi artistët nga Kosova për vizitorët në ngjarjet e ndryshme.

Të bindur se do ta njihni rëndësinë dhe shkallën kulturore të këtij projekti, kërkojmë një takim për të diskutuar mundësinë e bashkëpunimit në organizimin e Sallonit të 36-të Rinor dhe lidhjen me përfaqësues të skenës kulturore dhe artistike të Kosovës me qëllim të ndërlidhjes së sektorit kulturor të Kosovës dhe të Kroacisë.

Ambasadori Dr. Martin Berishaj, u falënderua për prezantimin e projekteve të HDLU duke shtuar se interes i ynë si shtet, është që arti, artistët dhe kultura nga Kosova në bashkëpunim me artistët kroat dhe me gjere, të jenë sa më shumë prezantë në Kroaci, në mënyrë që të prezantojnë vlerat tona para publiku kroat.

14. Ambasadori Dr. Martin Berishaj takon Ambasadorin e Republikës së Francës Z. Gaëll Veyssire

Më datën 08 shkurt, homologu francez u informua për të arriturat e Qeverisë së Kosovës lidhur me sundimin e ligjit, reformës në drejtësi, lufitës kundër krimtit dhe korruptionit, duke u ndalur në garancitë që shteti i Kosovës mbështet investimet e huaja, respektimin e lirive etnike dhe fetare.

Bashkëfolësit u ndalën në përkushtimin tonë rrëth dialogut me Serbinë duke konsideruar atë si një mundësi për paqe të qëndrueshme në Ballkan, fqinjësi të mirë dhe njohje reciproke në mes dy shteteve.

Në bisedë po ashtu u shpaluan edhe temat që kanë të bëjnë me sigurinë në rajon si dhe perspektivat e zhvillimit te tij.

Ambasadori Dr. Martin Berishaj i uroj Ambasadorit Veyssiére një fillim të mbarë në udhëheqjen të radhës franceze së presidencës së BE duke vure në dukje shpresën se Franca do t'i japë një dimension të ri konceptit evropian të zhvillimit.

15. Pjesëmarrje në programin shënimit të 30 vjetorit të marrëdhënieve diplomatike të Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Turqisë

Më datën 08 shkurt, me ftesën dhe nën organizimin e Shoqatës Kroato-Turke, dhe përkrahur nga Ambasada e Republikës së Turqisë në Zagreb, Eqrem Haziri-Këshilltar. mori pjesë në programin/koncertin për shënimin e 30 vjetorit të marrëdhënieve diplomatike të Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Turqisë, në të cilin të pranishëm ishin edhe përfaqësues të misioneve diplomatike të shteteve të rajonit, të akredituara në Kroaci.

Mysafirët i përshëndeten, organizatori programit, z. Goran Beus Richebergh, Kryetar i Shoqatës së Miqësisë Kroato-Turke, z. Frano Matushić, Sekretar i Shtetit për Çështjet Politike, dhe z. Mustafa Babür Hızlan, Ambasadori i Turqisë në Kroaci.

Në Sallën e koncerteve Lisinski, u mbajt koncert i organizuar nga Shoqatës Kroato-Turke, në të cilin z. Ivan Horvatić (Zürich), përformoi me piano, duke ekzekutuar kompozime te kompozitorëve të njohur, si: Franz Schubert, Franz Liszt, Ertogrol Bajraktar, Edvard Grieg, etj.

16. Kryetari i Komisionit për Çështje Evropiane Hajduković priti ambasadorin e Kosovës Berishaj

Më datën 09 shkurt, Ambasadori i Kosovës në Kroaci, Dr. Martin Berishaj dhe Këshilltari z. Eqrem Haziri u pritën në takim nga Kryetari i Komisionit për Çështje Evropiane Domagoj Hajduković, me të cilin Ambasadori Dr. Berishaj, zhvilloi një biseduar përmarrëdhëniet dypalëshe dhe për forcimin e bashkëpunimit parlamentar dhe rrugën e Kosovës përmarrëdhëniet dypalëshe dhe për forcimin e bashkëpunimit parlamentar dhe rrugën e Kosovës përmarrëdhëniet dypalëshe.

Në fillim Kryetari i Komisionit për Çështje Evropiane Domagoj Hajduković, tha se komiteti që ai drejton ka një fokus të veçantë në vendet e Evropës Juglindore dhe në këtë drejtim ne mbështesim fuqishëm perspektivën evropiane të të gjithë rajonit, duke shtuar se kjo mbështetje është shprehur në të gjitha nivelet e autoriteteve ekzekutive dhe parlamentare, por edhe ne shërbime profesionale.

Ai tha se përvèç mbështetjes përmarrëdhëniet dypalëshe, ai mbështet edhe përpjekjet e Kosovës përmarrëdhëniet dypalëshe e Këshillit të Evropës, dhe tha se më vjen mirë përmarrëdhëniet dypalëshe e interesimit dhe insistimin e gatishmërinë përmarrëdhëniet dypalëshe e Këshillit, ndërsa unë do të ju kërkoj kolegëve nga shtetet anëtarësim, jo vetëm atyre që Kosovët përkrahin përmarrëdhëniet dypalëshe, por edhe nga vendet mos-njohëse, që Kosovët përkrahin përmarrëdhëniet dypalëshe.

Gjithashtu sa i përket mbështetjes konkrete, ne jemi të gatshëm që kolegëve të Kosovës t'u ofrojmë të gjithë ekspertizën dhe ndihmën profesionale, veçanërisht kur bëhet fjalë përmarrëdhëniet dypalëshe e dimensionin parlamentar të anëtarësimit, duke u bërë thirrje kolegëve nga Kuvendi i Kosovës që të forcojnë shkëmbimet dhe vizitat parlamentare.

Ambasadori Berishaj, pasi falënderoi përmarrëdhëniet dypalëshe, tha se vlerëson të gjithë ndihmën dhe mbështetjen e Kroacisë si vend mik dhe theksoi se Kosova është e përkushtuar në përmbrëshjen e të gjitha reformave të nevojshme përmarrëdhëniet dypalëshe e Këshillit, ndërsa unë do të ju kërkoj kolegëve nga shtetet anëtarësim, jo vetëm atyre që Kosovët përkrahin përmarrëdhëniet dypalëshe, por edhe nga vendet mos-njohëse, që Kosovët përkrahin përmarrëdhëniet dypalëshe.

Ai gjithashtu theksoi se Kosova ka përmbrëshur kushtet përmarrëdhëniet dypalëshe e vizave, përmarrëdhëniet dypalëshe e liberalizimin e vizave, përmarrëdhëniet dypalëshe e kemi si shembull sa i përket standardeve, dhe jemi të përkushtuar maksimalisht dhe angazhuar ne hartimin e ligjeve, që është në përpjekjet e Kosovës përmarrëdhëniet dypalëshe e reformave të drejtësise, demokratizimin e institucioneve dhe administratës përmarrëdhëniet dypalëshe e dëshmuar se jemi një partner i besueshëm në ruajtjen e sigurisë, theksoi Dr. Berishaj.

Ai gjithashtu theksoi se Kosova ka përmbrëshur kushtet përmarrëdhëniet dypalëshe e liberalizimin e vizave, përmarrëdhëniet dypalëshe e kemi si shembull sa i përket standardeve, dhe jemi të përkushtuar maksimalisht dhe angazhuar ne hartimin e ligjeve, që është në përpjekjet e Kosovës përmarrëdhëniet dypalëshe e reformave të drejtësise, demokratizimin e institucioneve dhe administratës përmarrëdhëniet dypalëshe e dëshmuar se jemi një partner i besueshëm në ruajtjen e sigurisë, theksoi Dr. Berishaj.

17. Ambasadori Dr. Martin Berishaj priti Ministrin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Faton Peci

Më datën 09 shkurt, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural z. Faton Peci me bashkëpunëtorë, i shoqëruar nga ambasadori i Kosovës Dr. Martin Berishaj, zhvilloi takim zyrtar dyditorë në Kroaci, me ç' rast u takua me homologen e vet kroate mr.sc Marija Vučković.

Po ashtu në ambientet Ambasadës së Republikës së Kosovës në Zagreb, ambasadori Dr. Martin Berishaj priti Ministrin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Faton Peci me bashkëpunëtorë, me të cilët zhvilluan një bisedë lidhur me shtimin e aktiviteteve, në mënyrë që të ngrisim bashkëpunimin, edhe ashtu shumë të mira me Republikën e Kroacisë në fushën e bujqësisë.

18. Takim në Ministrinë e Punëve Detare, Transportit dhe Infrastrukturës në Republikën e Kroacisë

Më datën 14 shkurt, Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës, ambientit dhe planifikimit hapësinor z. Liburn Aliu. Ministri Aliu, ishte në një vizitë zyrtare në Kroaci. Ai vizitoi Ministrinë e Punëve Detare, Transportit dhe Infrastrukturës në Republikën e Kroacisë, ku u prit nga Ministri z. Oleg Butković, me të cilin u shkëmbyen përvoja dhe ide të ndryshme për rëndësinë dhe intensifikimin e bashkëpunimit në fushën e transportit dhe infrastrukturës.

Në funksion të forcimit të marrëdhënieve dypalëshe ministrat u dakorduan që të bashkëpunojnë në fushën ekonomike, veçanërisht në fushën e transportit dhe infrastrukturës hekurudhore, e po ashtu në nivel institucional. Dy Ministrat u dakorduan se transporti dhe krijimi i lidhjeve më të sigurta janë vendimtare për rritjen ekonomike dhe miqësinë ndërmjet dy vendeve, në kuadër të proceseve të integrimit drejt një ekonomie zhvillimore, të cilën mund të përfitojmë nga bashkëpunimi i ndërsjellë.

Ministri Butković me bashkëpunëtorë e pranoi me kënaqësi ftesën e Ministrit Aliu për të vizituar Kosovën gjatë muajit prill.

19. Takim me përfaqësuesin e kompanisë ‘Ericsson Nikola Tesla d.d.’ në Ambasadën e RKS Zagreb

Më datën 14 shkurt, në hapësirat e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Zagreb, është mbajtur takimi i Ministrit i Ministrisë së Infrastrukturës, Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Liburn Aliu, Dr. Martin Berishaj, Ambasador dhe z. Eqrem Haziri, Këshilltar, me përfaqësuesin e kompanisë ‘Ericsson Nikola Tesla d.d.’, Zagreb, z. Vjeran Buća.

Ministri, z. Aliu, u interesua që përfaqësuesin e kompanisë, z. Buća të njoftoi disa informata fillestare me shërbimet ~~dhe~~ produktet që ofron kompanisë ‘Ericsson Nikola Tesla d.d’, me qëllim të shikimit të mundësive të bashkëpunimit dhe investimeve në Kosovë, nga kjo Kompani.

Z. Vjeran Buća, në fillim theksoi se firma në kuadrin e kompanisë e kemi edhe të ashtuquajturën Drejtorinë kufitare, me të cilin menaxhojmë vijën kufitare me Serbinë dhe Bosnje dhe Hercegovinën, me sensor. Sa i përket pjesës së sigurisë, kemi aspektin e informimit në shumë sisteme. Kështu që kemi në menaxhim sistemet në disa ministri, si: në atë të administratës publike (sistemi i menaxhimit të procedurave administrative), sistemin e kadastrit dhe librat e tokës, si dy sisteme të bashkuara (pronat-pronarët dhe gjeosituata). Tani në Kroaci ka vetëm 5% të sipërfaqes, me informata të papërpunuara.

Ministri, z. Aliu, në vazhdim tha se do të propozojta të organizojmë një takim në Kosovë në Zyrën e Kryeministrat, ku do të takoheshit me këshilltarin i cili merret më këto punë, pastaj do të zhvillonim takime edhe në ministritë tjera, ku do të shihnim mundësitë e bashkëpunimit për zhvillimin e projekteve të kësaj natyre, duke

theksuar se në disa sektorë kemi të zhvilluara disa pjesë të këtyre sistemeve të sigurisë, duke theksuar që informatat e të gjitha llojeve do të bëhen në mënyrë që të janë kompatibile me sistemin unik.

Përfaqësuesi i kompanisë ‘Ericsson Nikola Tesla d.d.’ z. Vjeran Buća, duke elaboruar sistemin e ri të informimit/sigurisë për kadastër tha se ai ofron eficiencë dhe efikasitet më të mirë të kryerjes së punëve, të sigurt dhe të shpejt, nga se tani sistemi është zvogëluar mundësia dhe nuk lenë hapësirë në vullnetin dhe neglizhencën e zyrtarit, por ka të përcaktuara dhe definuar afate të veprimit, dhe njëkohësisht ishte i pajtimit për të zhvilluar takime në institucionet përkatëse Kosovare, në mënyrë që me njerëzit e profesionit dhe kompetent të shohim dhe identifikojmë fushat dhe mundësitë e bashkëpunimit, dhe propozoi që të kyçen edhe kompanitë vendore, në mënyrë që të janë në gjendje pas përfundimit të vazhdojnë të mbikëqyrin funksionimin e sistemeve, në rast nevoje.

20. Ambasadori sloven në Kroaci z. Vojislav Šuc e pranoi në takim ambasadorin e Kosovës Dr. Martin Berishaj

Më datën 15 shkurt, Ambasadori sloven në Kroaci z. Vojislav Šuc e pranoi në takim ambasadorin e Kosovës Dr. Martin Berishaj. Bashkëbiseduesit u dakorduan se Republika e Slovensës dhe

Republika e Kosovës kanë marrëdhënie të shkëlqyera dhe se thellimi dhe intensifikimi i ketyre marrëdhënieve politike duhet të rezultoi edhe në fushën ekonomike dhe në ngritjen e këmbimeve ekonomike në mes dy shteteve. Sa i përket situatës politike dhe asaj të sigurisë në rajon e në veçanti lidhur me Kosovën, ambasadori Dr. Berishaj shtoi, se intanca jonë është politika e fqinjësise së mirë, ndërtimi i shtetit të së drejtës, lufta kundër korruptionit, si dhe synimi që dialogu me Serbinë të rezultojë me njohje reciproke për çka homologët u dakorduan në plotni.

Ambasadori sloven Šuc e njoftoi po ashtu Dr. Berishaj edhe përrnjedhën më të relaksuar të marrëdhënieve në mes Kroacisë dhe Slovensës si dy shtet fqinje, duke shtuar se si shtete anëtarë të BE e përcjellin me vëmendje te shtuar situatën politike dhe të sigurisë në rajon.

21. I ngarkuari me punë i Republikës së Malit të Zi, z. Damir Grbović, e priti në takim Ambasadorin Republikës së Kosovës në Kroaci Dr. Martin Berishaj.

Më datën 16 shkurt, I ngarkuari me punë i Republikës së Malit të Zi, z. Damir Grbović, e priti në takim Ambasadorin Republikës së Kosovës në Kroaci Dr. Martin Berishaj, ku bashkëbiseduesit u dakorduan se Republika e Kosovës dhe Republika e Malit të Zi, si shtete fqinje, kanë synime të qarta dhe pa kusht lidhur me proceset euroatlantike si dhe integrimet evropiane.

Z. Grbović e njoftoi ambasadorin Dr. Berishaj, përsituatën politike dhe atë të sigurisë në Mal të Zi pas rënies së qeverisë së z. Krivokapić dhe proceseve rreth formimit të kabinetit qeveritarë të ri malazias.

Dr. Berishaj theksoi se gjendjen në shtetin fqinjë e përcjellim me interes të shtuar dhe se interes i Kosovës është pa dyshim që Mali i Zi si shtet anëtarë i NATO-s, është garanci e paqes dhe stabilitetit në rajon, kurse ndërrrimin e qeverisë në Mal të Zi e shohim si proces të natyrshëm demokratik, të vullnetit të lirë të qytetarëve të tij.

Për ne si Kosovë, ka rëndësi të veçantë që me Malin e Zi të thelojmë marrëdhëni tonë të mira duke u fokusuar edhe në diplomacinë ekonomike që nënkupton rritjen në nivel të duhur të këtyre marrëdhënieve, kurse Mali i zi të vazhdojë rrugëtimin e vet në proceset integruese politike evropiane, shtoi ambasadori Dr. Berishaj.

22. Pjesëmarrje në programin shënimit të 14 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, në Osjek/Kroaci

Më datën 17 shkurt, me ftesën e Shoqatës Bashkësisë Shqiptare Kombëtare për Sllavoni dhe Baranjë, z. Egrem Haziri-Këshilltar, mori pjesë në programin për shënimin e 14 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, i cili u mbajt me organizimin e Shoqatës dhe përkrahur nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Zagreb, Unioni i Shqiptarëve në Republikën e Kroacisë dhe Deputetës në Parlamentin Kroat, znj. Ermina Lekaj Prljaskaj.

Z. Haziri, i përshëndeti të pranishmit duke ju uruar Përvjetorin e 14 të Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Ai më pastaj theksoi se shpallja e Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008, është kurorëzim i një rrugëtimi të gjatë e të vështirë e Popullit të Kosovës, duke kujtuar shumë sakrifika që i kanë paraprirë kësaj dite të jashtëzakonshme:

‘Kujtojmë paraardhësit të cilët që nga fillimi i shekullit të kaluar, u angazhuan, vepruan, sakrifikan, vuajtën dhe dhanë më të shtrenjtën përkrahur edhe nga më të cilët ishin me ne edhe gjatë rimëkëmbjes së pasluftës, rindërtimit të vendit të shkatërruar nga lufta dhe okupimi, përkrahur edhe nga mënyrë që bijtë dhe bijat e tyre të mund të jetonin të lirë. Për vite me radhë qytetarët e Kosovës vuajtën pasojat e spastrimit etnik nga regjimi serb i Sllobodan Miloshevićit, gjë e cila rezultoi më një Luftë Çlirimtare të viteve 1997-99’.

‘Pavarësinë e shtetit tonë kemi shpallur edhe me bekimin e botës përparimtare, me ndihmën e miqve tanë që u gjetën pranë nesh gjatë dekadave kur e keqja kishte përfshirë këtë pjesë të Ballkanit.

Shtetin e Kosovës aktualisht e kanë njojur 117 shtete, dhe atë shtetet më të forta e më demokratike të Botës përparimtare, të përkrahur edhe nga miq të cilët ishin me ne edhe gjatë rimëkëmbjes së pasluftës, rindërtimit të vendit të shkatërruar nga lufta dhe okupimi, përkrahur edhe nga mënyrë që bijtë dhe bijat e tyre të mund të jetonin të lirë. Për vite me radhë qytetarët e Kosovës vuajtën pasojat e spastrimit etnik nga regjimi serb i Sllobodan Miloshevićit, gjë e cila rezultoi më një Luftë Çlirimtare të viteve 1997-99’.

Në këtë manifestim e pranishmë ishte edhe Deputete në Parlamentin Kroat znj. Ermina Lekaj Prljaskaj, e cila ju drejtua të pranishmëve me fjalë rastit, duke ju uruar Përvjetorin e 14 të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

23. Pritje e Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Kroaci Dr. Martin Berishaj, në Ambasadën e SHBA në Kroaci

Më datën 11 shkurt, I ngarkuari me punë i SHBA-ve në Kroaci, Shkëlqesia e Tij Z. Mark Fleming e priti ne takim zyrtar Ambasadorin e Republikës së Kosovës Dr. Martin Berishaj.

Në takim, u bisedua përsituatën në rajon, dhe u konfirmua pajtimi mbi rrugën e drejtë të Qeverisë së Kosovës, lidhur me ndërtimin e shtetit të së drejtës, luftës kundër korruptionit, reformave në shtetësi si dhe për orientimin euroatlantik të Kosovës.

24. Pjesëmarrje në kremin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës në prefekturën e Bregdetare-Malore

Më datën 18 shkurt, ambasadori i Kosovës Dr. Martin Berishaj me bashkëpunëtorë mori pjesë në kremin e Ditës së Pavarësisë që e kishte organizuar Bashkësia shqiptare në prefekturën e Bregdetare-Malore, (PGŽ) ku kishte edhe takime të ngjeshura me përfaqësues të prefekturës dhe në qytetit të Rijekës. Në këtë kremin mori pjesë edhe ambasadori i Republikës së Maqedonisë Veriore Dr. Milaim Fetai, kryetarja e asamblesë se Qytetit Rijekes z. Ana Troselj, si dhe përfaqësuesit e prefekturës.